

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”
Programi i lëndës

GJUHË E HUAJ E DYTË
Shkalla 3
Klasa 7



SHTATOR 2014

Hyrje

Gjuha e Huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, etj.) bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar, i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tyre personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Mësimi i gjuhës shqipe dhe i gjuhëve të huaja i ndihmon nxënësit që të bëhen individë të pavarur, të lirë, të kulturuar, mendimtarë kritikë dhe krijues, njerëz të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose gjuhë të huaj), nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhët, kulturën kombëtare dhe botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësve për të bërë një komunikues të mirë, lexues aktiv e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinal dhe krijues. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë janë një nga detyrat parësore të arsimit, të cilat synojnë të përmbushin pesë kompetencat: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës.


Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Gjuhë e huaj e parë, Gjuhë e huaj e dytë.

Gjuha shqipe mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, nga klasa përgatitore deri në klasën XII.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha angleze, gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha angleze, gjuha gjermane etj.

I. Korniza konceptuale e programit



II. Qëllimet e programit të lëndës «Gjuha e huaj e dytë»

Qëllimet e lëndës gjuhë e huaj e dytë në arsimin bazë janë:

- Zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues.
- Përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë nxënësit.
- Gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi i informacioneve

Programi mësimor i lëndës gjuhë e huaj e dytë për klasen 7 është hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar, si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Lënda e gjuhës së huaj ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësve për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka detyrë të zhvillojë te nxënësit aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe t'i edukojë ata me të kuptuarit, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë. Nxënësit gjithashtu mësojnë dhe binden që gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe mjet komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t'u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj e dytë është një lëndë kulture dhe aftësish.

Mësimi i gjuhës së huaj në klasën e shtatë të arsimit nëntëvjeçar zhvillohet në nivelin **A1.1+** (Niveli hyrës, apo i zbulimit të gjuhës), duke iu referuar *Kuadrin të Përbashkët Evropian të Referencave për gjuhët*. Në fund të klasës së shtatë, nxënësi mund të kuptojë dhe të përdorë shprehje të njohura dhe të përditshme për të plotësuar nevoja konkrete

Klasa 7 niveli A1.1+

Interesat dhe tematikat në këtë program do të jenë të ndryshme, pasi shkalla e ndërgjegjësimit të nxënësit për domosdoshmërinë e mësimit të gjuhës së huaj është më e lartë dhe mësimi i gjuhëve të huaja lidhet me problemet e formimit e të ardhmes së tij si qytetar evropian. Përvetësimi i gjuhës së huaj kontribuon jo vetëm në pasurimin dhe në lulëzimin e individualitetit të nxënësit, por edhe në ndërtimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve etike që i shërbejnë komunitetit dhe krijimit të një qytetari të ri evropian.

III. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës / lëndës




Tabela: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj.

Klasa 7

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

- Shpreh përjetimet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit dhe dëgjimit të një filmi, dokumentari, ekspozite, dramatizimi, recitimi, etj. në njërin nga format shprehëse (me gojë, me shkrim, vizatim, mimikë, lëvizje etj).
- Dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me fjali të thjeshta, mbi tema të njohura, me kusht që bashkëfolësi të jetë i gatshëm të përsërisë apo riformulojë frazat e tij.
- Lexon saktë me zë një tekst të shkurtër me fjalë të njohura dhe tematikë nga jeta e përditshme.
- Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge, etj., dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
- Shpreh me gojë dhe me shkrim fjali të thjeshta në gjuhën e huaj dhe i përkthen në gjuhën amtare.
- Shkruan një kartolinë të shkurtër e të thjeshtë, një urim.

Kompetenca e të menduarit

- Sqaron me anë të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.
- Identifikon për një temë/ngjarje, personazhet, kohën, vendin, etj.
- Shprehet pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

Kompetenca e të nxënit

- Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst të thjeshtë për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet .
- Pyet dhe përgjigjet lidhur me tematika nga jeta e përditshme, me një fjalor të thjeshtë.
- Zgjidh në mënyrë të pavarur, por edhe me ndihmën e mësuesit problemin, detyrën e dhënë duke e prezantuar para të tjerëve.
- Shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për përgatitjen e një teme të dhënë.
- Identifikon dhe krahason informacionet e njohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar nga jeta e përditshme duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh duke i shënuar me shenja të ndryshme).
- Krahason përparimin e tij, me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një veprimtarie të caktuar.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

- Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet,..etj) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
- Prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, si dhe profesionin e dëshiruar.
- Përgatit një plan pune një javor.
- Diskuton me një fjalor të thjeshtë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar e konkrete.

Kompetenca personale

- Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në

aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.

- Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët. (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare

- Përcakton rregullat e punës në grup në bashkëpunim me anëtarët e grupit.
- Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit, duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët, për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
- Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

Kompetenca digjitale

- Identifikon personazhet, kohën, vendin e një teksti të shkurtër të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), të shprehur qartë dhe ngadalë.
- Realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre.
- Përdor teknologjinë digjitale për të gjetur informacionin e nevojshëm.

IV. Lidhja e gjuhës së huaj me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënësve, të cilat ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në Kornizën Kurrikulare dhe në kurrikulat bërthamë janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të cilat janë:


- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Gjuha e huaj zhvillon te nxënësit njohjen e vlerësimin e kulturës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore të kompetencës së të folurit. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme. Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj të dytë, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

V. Lidhja e gjuhës së huaj të dytë me fushat e tjera kurrikulare

Gjuha e huaj e dytë i pajis nxënësit me njohuri, aftësi dhe shkathhtësitë që sigurojnë suksesin e nxënësve edhe në fushat dhe lëndët të tjera. Kjo lëndë u mundëson atyre që të kuptojnë tekste ose mesazhe të ndryshme, të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte.

Më konkretisht, këto njohuri dhe aftësi janë dhënë në tabelën e mëposhtme:



VI. Ndarja e orëve mësimore

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit Bazë.

Orët Mësimore 35 javë x 2 orë = 70 orë vjetore

Programi i gjuhës së huaj të dytë për arsimin bazë, përcakton raportin: Komunikim, Formim kulturor dhe Formimi gjuhësor.

Kjo krijon mundësi për formimin e aftësive dhe shprehive afatgjatë tek nxënësit.

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) objektivat sipas kompetencave të përshkruara më lart ndërthuren me njëra-tjetrën dhe mund të zënë vend aty ku përdoruesi e sheh më të arsyeshme për t'i zbatuar. Konceptimi i kapitujve të tekstit dhe njësive mësimore është e drejtë dhe detyrë e autorit të tekstit dhe mësuesit. E rëndësishme është në këtë rast, që zbatuesit e programit të jenë të vëmendshëm në realizimin cilësor të të gjitha objektivave të përcaktuara në këtë program.

| Shkalla e tretë | Komunikim dhe formim kulturor | Formimi gjuhësor | Orë/vit |
|------------------------|--------------------------------------|-------------------------|----------------|
| Klasa e shtatë | 40 orë | 30 orë | 70 orë |
| Total | 40 orë | 30 orë | 70 orë |

Shkalla 3 - Klasa 7

Kompetenca: Të dëgjuarit

Përshkrimi i kompetencës

- Nxënësi demonstroi sjellje dhe qëndrime të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, pëlqim dhe interes. Ai dëgjon dhe kupton fjalë e tekste të shkurtra, (nga jeta e përditshme, nëse flitet ngadalë dhe qartë), demonstroi se i ka kuptuar ato, si dhe shpreh opinionet e tij rreth asaj që dëgjon.
- Nxënësi demonstroi njohuri, aftësi, qëndrime mbi marrëdhëniet komunikative dhe kulturore në situata të thjeshta, të njohura më parë, për të plotësuar nevojat konkrete. Nëpërmjet situatave të ndryshme, tërheqëse për moshën, realizohet zhvillimi i gjithanshëm i nxënësit në aspektin njohës, gjuhësor, emocional dhe kulturor. Nxënësit prezantojnë dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin për plotësimin e nevojave dhe interesave për familjen, shkollën dhe shoqërinë, si edhe për kulturën e vendeve të ndryshme.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të dëgjuarit

Nxënësi:

- Tregon se kupton pikat kryesore të një pjese të shkurtër me një gjuhë shumë të thjeshtë.
- Shpreh kuptimin e dialogëve dhe mesazheve të reja, të përcjella me gjuhë të thjeshtë.
- Reagon ndaj pikave kryesore dhe hollësirave të rëndësishme.
- Ai mund të ketë nevojë për përsëritje.

Njohuritë për realizimin e kompetencës**Aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e kompetencës**

| | |
|--|---|
| <p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Alfabeti i gjuhës së huaj nëpërmjet pjesëve të thjeshta të vjershave, këngëve, lojërave, etj. • Fjalë dhe përshëndetje të thjeshta të jetës së përditshme (mirëdita, si je?) • Pyetje të thjeshta rreth njerëzve të njohur. • Ditët e javës. • Udhëzime shumë të thjeshta (hap librin, mbyll derën, hyr, dil, ulu, ngrihu, fol, përgjigju, etj.) • Studime tekstesh të tilla si: gjëgjëza, dialogë të shkurtër, dramatizime të ndryshme, shfaqje për fëmijë, rregulla praktike etj. | <p>Të dëgjuarit Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dëgjon dhe reagon ndaj fjalive të thjeshta, të artikuluar ngadalë dhe me gjuhë të qartë; • identifikon objekte të ndryshme, kur ato dëgjoen, përmenden apo tregohen; • identifikon udhëzime të thjeshta në klasë dhe jashtë saj; • reagon përmes veprimtarive fizike ndaj orientimeve, udhëzimeve dhe veprimeve të mësuesit apo të njerëzve që e rrethojnë. • dëgjon dhe reagon ndaj përshëndetjeve dhe urdhrave; • identifikon objekte të ndryshme, kur i kërkohet të përgjigjet rreth tyre; • reagon ndaj pyetjeve të thjeshta. |
| <p>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</p> | |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shfaq sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si p.sh: ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon; nuk e ndërpret tjetrin, kur është duke folur; e sheh në sy personin gjatë kohës që flet; shpreh pëlqim dhe interes ndaj asaj që dëgjon | |

Kompetenca: Të folurit

| | |
|---|---|
| Përshkrimi i kompetencës <ul style="list-style-type: none">Nxënësi shqipton saktë dhe me intonacionin e duhur fjalët. Ai shpreh saktë dhe kuptueshëm mendimet e tij, shoqëron të folurin edhe me elemente joverbale, bashkëpunon në grup, si dhe merr pjesë në lojëra me role. Merr pjesë në biseda të shkurtra. Kërkon dhe përcjell informacion, duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve për përjetime aktuale. | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të folurit | |
| Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">komunikon në mënyrë të thjeshtë, kur folësi është i qartë në bashkëbisedim;flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, fjali të thjeshta e të shkurtra;diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta;përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe ekspozitave në klasë;merr pjesë në lojë me role. | |
| Njohuritë për realizimin e kompetencës | Aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e kompetencës |
| Njohuritë për klasën e shtatë <ul style="list-style-type: none">Krijimi i një baze shprehish, aftësish dhe qëndrimesh të nevojshme për mësimin e gjuhës së huaj të dytë.Alfabeti i gjuhës së huaj nëpërmjet pjesëve të thjeshta të | Të folurit Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë;reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendësh;merr pjesë lojë me role (me ndihmën e mësuesit ose të një të |

| | |
|--|---|
| <p>rimave, vjershave, këngëve dhe lojërave etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emri, mosha, vendbanimi. • Përshkrim me një fjalor shumë të thjeshtë për njerëzit e njohur. • Përdorimi i formulave më të thjeshta të mirësjelljes (të lutem, më fal, mirëdita). • Numrat nga 1-20. | <p>rrituri);</p> <ul style="list-style-type: none"> • shoqëron të folurin me shprehjen e duhur të fytyrës dhe gjestet e përshtatshme; • përdor gjatë prezantimeve të tij edhe elemente të tilla si: foto dhe piktura; • pyet, përgjigjet, shpreh mendime, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë (kryesisht brenda klasës). <p><i>Të folurit ndërveprues</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • bën pyetje të thjeshta për atë çfarë sheh ose dëgjon duke shprehur dëshirat, ndjenjat dhe parapëlqimet; • pyet dhe kërkon sende që i nevojiten për të kryer një punë; • pyet dhe u përgjigjet pyetjeve të thjeshta për veten, familjen, shkollën dhe vendbanimin; <p><i>Prodhimi i të folurit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton veten duke përdorur fjali të thjeshta; • thotë emrin, moshën dhe vendbanimin; • flet thjesht për njerëzit e njohur dhe familjen. |
| <p>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</p> | |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh fjalorit e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes). | |

| |
|--|
| |
|--|

Kompetenca: Të lexuarit

| | |
|--|--|
| Përshkrimi i kompetencës | |
| <ul style="list-style-type: none">Nxënësi kupton emra të njohur, fjalë dhe fraza të thjeshta, (lajmërimet, afishe,). Lexon tekste të thjeshta letrare dhe joletrare. Ai përdor strategji të thjeshta për të kuptuar tekstin si: lidh tekstin me njohuritë e mëparshme, rilexon, kërkon përsëritje, pyet rreth paqartësive, mban shënime, bën nënvizime etj. Nxënësi demonstroi kuptimin e tekstit duke identifikuar personazhet, vendin, kohën dhe dhe jep mendimet e tij rreth asaj që lexon. (i pëlqen/nuk i pëlqen, etj.) | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të lexuarit | |
| Nxënësi: | |
| <ul style="list-style-type: none">përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;lexon me zë një tekst të shkurtër dhe identifikon personazhet kryesorë, tregon funksionin e pjesëve plotësuese të tekstit (p.sh., foto, vizatim, pamje etj.);jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar (vjershë, përrallë,) dhe joletrar (kalendar, gjë e gjëzë). | |
| Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës | |
| Njohuritë | Aftësitë dhe shkathtësitë |
| Njohuritë për klasën e shtatë | Të lexuarit fillestar Nxënësi: |

| | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i shkronjave të alfabetit. • Identifikimi i informacionit përmes figurave për anëtarë të familjes, shokët, lojërat, etj. • Të dhëna personale, emër, adresë, ditëlindje, në një formular ose pyetësor të thjeshtë. • Mesazhe, komente shumë të thjeshta mbi detyrat, punën, etj. | <ul style="list-style-type: none"> • dallon fjalë dhe fraza të njohura, të mësuar më parë; • hamendëson kuptimin e fjalëve apo frazave në tekst ose në bazë të figurave, pamjeve të ndryshme; • lexon tekste të shkurtra që përmbajnë fjalë dhe fraza me fjalor të njohur nga fondi bazë i gjuhës së huaj; • shqipton drejt tingujt, fjalët. <p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti, ose rreth fjalëve të panjohura për të (Ku? Kur? Pse? Si ndodh kjo? Çfarë do të thotë?); • rilexon tekstin për të kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme); • dallon të dhëna personale në një pyetësor të thjeshtë; • identifikon mesazhe, komente shumë të thjeshta mbi detyrat dhe punën e bërë; <p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon vjersha të shkurtra, gjëegjëza etj; • përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin. <p>Të lexuarit e teksteve joletrare</p> <p>Nxënësi:</p> |
|--|--|

| | |
|---|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekste joletrare si: udhëzime, kartolina, etj.; |
| Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës | |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mban trupin në një qëndrim të përshtatshëm dhe librin në pozicionin e duhur gjatë kohës që lexon; • lexon me interes, emocion, dëshirë dhe me ndjenjë. | |
| Kompetenca: Të shkruarit | |
| Përshkrimi i kompetencës | |
| <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi shkruan një kartolinë urimi, të shkurtër dhe të thjeshtë, etj. Mund të sjellë detaje personale në një pyetësor, shkruan emrin, mbiemrin, kombësinë, adresën. Shkruan fjali të thjeshta dhe të shkurtra mbi tematika të njohura. | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të shkruarit | |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan për të komunikuar idetë e veta te të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive të shkurtra, etj.; • shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna. | |
| Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës | |
| Njohuritë | Aftësitë dhe shkathtësitë |

| | |
|--|---|
| <p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Plotësim i të dhënave personale në një formular (emër, mbiemër, adresë). • Kopjimi i fjalëve dhe fjalive të shkurtra të marra nga teksti ose gjatë një ore mësimi në klasë. • Ndërtimi i fjalive me anën e etiketave. • Shkrimi i një kartoline të thjeshtë urimi. (për ditëlindje, vitin e ri, krishtlindje, etj). | <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dallon dhe zgjedh fjalë të përshtatshme për të plotësuar vende bosh në fjali apo fjalë të renditura në formë liste; • etiketon objekte rrethore; • formulon një kartolinë të thjeshtë urimi, duke përdorur fjalë ose fraza të shkurtra dhe standarde; • plotëson vende bosh me fjalë duke iu referuar figurave apo pikturave të njohura; • emërton një etiketë për një send të njohur. <p>Të shkruarit si produkt</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të; • rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: <i>Kush? Cili? Çfarë? Kur? Ku?</i> etj.; • shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë, drejtuar një shoku duke përdorur një model të thjeshtë; |
| <p>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</p> | |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mban gjatë të shkruarit pozicionin e duhur të trupit, dorës, fletores ose fletës ku shkruan. | |

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

| | |
|--|--|
| Përshkrimi i kompetencës | |
| <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi dallon fjalitë në një tekst. Ai zhvendos, shton ose heq fjalë në një fjali pa e prishur kuptimin e saj. Nxënësi dallon fjalitë pyetëse dhe dëftore, pohore dhe mohore si dhe vendos shenjat e pikësimit në fund të tyre. Ai nis të dallojë emrin, mbiemrin, foljen, përemrin, nyjet shquese dhe jo shquese, numërorin. | |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencën e përdorimit të drejtë të gjuhës | |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> Dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës. (shumësi i rregullt) Zgjedhon folje të rregullta (folja jam/kam, etj.) në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme, sipas modeleve të dhëna. Dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pohore, pyetëse, dhe mohore, duke respektuar shenjat e pikësimit. Dallon mbiemrin si fjalë, që tregon cilësi të emrit. Gjen dhe formon fjali me përemra vetorë dhe me numërorë. Dallon nyjet shquese dhe jo shquese | |
| Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencave lëndës | |
| Njohuritë | Aftësitë dhe shkathtësitë |
| Njohuritë për klasën e shtatë <ul style="list-style-type: none"> Emri. Përemri. (vetor njëjës e shumës, përemri dëftor, etj.) | <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon fjalitë në një tekst; ndërton fjali me etiketa; dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh; dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore; |

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Mbiemri. • Nyjet shquese dhe jo shquese. • Shumësi i emrave të rregullt. • Folja jam, kam dhe disa folje të rregullta në kohën e tashme. • Parafjalët, në, mbi, etj. | <ul style="list-style-type: none"> • dallon emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës. (shumësi i rregullt) • gjen në një tekst fjalët që tregojnë veprim; • zgjedhon foljet jam, kam dhe disa folje të rregullta në kohën e tashme. • Formon fjali me përemrat vetorë: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato. |
| Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës | |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • paraqet dhe komunikon me gjuhë të thjeshtë mendimet e tij; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet personale dhe ato në grup. | |

VII. Udhëzime metodologjike

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor të nxënësve.

Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen* etj. shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënësve dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënësve. Mësimdhënia e gjuhës së huaj duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për arsye të ndryshme si si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e gjuhëve të huaja kërkon që nxënësit të nxënë konceptet, të zotërojnë shprehjet dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënësi të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh do të nxitin të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

Integrimi

Linjat e programit: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe njohuri rreth sistemit gjuhësor do të trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Asnjëherë nuk mund të bëhen veprimtari vetëm për njërin nga linjat e programit. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku. Një lidhje e fortë ndërmjet këtyre linjave forcon cilësinë e të nxënit të nxënësve.

Procesi i rimarrjes së njohurive

Aftësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor, llojet e ndryshme të teksteve do të zhvillohen duke u rishikuar dhe rishqyrtuar vit pas viti, por në një nivel më të lartë vështirësie. Kjo do t'u mundësojë nxënësve të përparojnë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

VIII. Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është një komponent themelor i programit të gjuhës së huaj të dytë, i cili shoqëron dijen e përfutur gjatë gjithë procesit mësimor. Vlerësimi i dijeve në këtë moshe mbështetet tek objektivat dhe standardet që përcakton ky program. Si rezultat, vlerësimi ka këto pikësnyime:

- Të nxisë nxënien dhe zhvillimin personal të nxënësve;
- Të identifikojë nxënës me nevoja dhe interesa të veçanta;
- Të monitorojë ecurinë e programit dhe të vlerësojë efikasitetin e tij;
- Të mbledhë të dhënat nga rezultatet e nxënësve sipas banchmark-ut te niveli A1 për llogari të realizimeve të qëllimeve dhe standardeve, si dhe
- Të përcaktojë pritshmëritë në të ardhmen tek nxënësit e kësaj moshe, pavarësisht nga ndryshimet e tyre individuale, gjuhësore, emotive, shoqërore dhe kulturore.

Për këtë moshë rëndësi ka vlerësimi pozitiv i nxënësit. Asgjë nuk është më nxitëse sesa suksesi i arritur, dhe kjo arrihet vetëm duke e motivuar këtë moshë gjatë gjithë procesit të nxënies së dijeve në gjuhën e huaj të dytë.

Kur vlerësimi i gjithë procesit të mësimdhënies e nxënies në klasën 7 bëhet në përputhje me kushtet e programit, ai, i ndihmon mësuesit:

- të diagnostikojnë pikat e dobëta dhe mundësitë e nxënësve,
- të vlerësojnë metodën e mësimdhënies,
- t'u tregojnë nxënësve nëse i kanë arritur objektivat.

Për vlerësimin e nxënësve, mësuesit duhet të mbështeten në disa parime bazë:

- Vlerësimi, i cili është pjesë thelbësore e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Ai duhet të jetë një ***veprimtari e planifikuar, e vijueshme*** që ka lidhje të ngushtë si me programin, ashtu dhe me mësimdhënien.
- Vlerësimi duhet ***të udhëhiqet nga rezultatet e synuara të të nxënies*** të programit dhe të përdorë shumëllojshmëri strategjish dhe teknikash vlerësimi me pikësynim arritjen e standardeve.

- **Planet e vlerësimit duhet t'u bëhen të ditura nxënësve dhe prindërve më parë në kohë.** Nxënësve duhet t'u jepen mundësitë për t'u përgatitur për vlerësim. Ndërsa prindërit duhet të vihen në dijeni për gjendjen reale të suksesit të fëmijëve të tyre në shkollë.
- Vlerësimi duhet të jetë **i ndershëm dhe i paanshëm.** Ai duhet të jetë i ndjeshëm kundrejt situatave familjare, të klasës, të shkollës dhe të komunitetit; ai duhet të jetë i paanshëm. Nxënësve duhet t'u jepen mundësitë të demonstrojnë shkallën e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të tyre.
- Vlerësimi **duhet të jetë ndihmues për të gjithë nxënësit.** Ai duhet t'u japë atyre informacion pozitiv dhe nxitës për t'u përfshirë aktivisht në procesin e të nxënës.

Nëpërmjet vlerësimit, mësuesit “zbulojnë” shkallën e përfundimit e të konsolidimit (nga ana e nxënësit) të njohurive, aftësive dhe shprehive të përfshira në këtë program.

Vlerësimi duhet të jetë:

- a. Vlerësim i vazhdueshëm me gojë.
- b. Vlerësim me shkrim

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë klasifikohet në:

- Vlerësim formues, me anë të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënësit në formimin e tyre gjuhësor në përputhje me objektivat e caktuara.
- Vlerësim diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimin e materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai, gjithashtu, jep informacion për efektshmërinë e të nxënës dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.

- Vlerësim i planifikuar mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.
- Vlerësim motivues, ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënësit për mësimin e gjuhës angleze. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor.

Vlerësimi përfundimtar është vlerësimi me notë që finalizon arritjet e objektivave të linjave dhe nënlinjave për këtë moshë.

Vetëvlerësimi është element i rëndësishëm në mësimin e gjuhës angleze për këtë moshë. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi. Gjatë vetëvlerësimit në procesin mësimor ndiqen këta hapa:

- Mësuesit diskutojnë me nxënësit atë që ata do të arrijnë në klasë;
- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi/ja dhe nxënësit bëjnë komentin përfundimtar;
- Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe duke marrë role të ndryshme, madje ndonjëherë dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit/es;
- Nxënësit mbajnë shënime arritjet e tyre duke përdorur edhe gjuhën amtare;
- Mësuesit bisedojnë me nxënësit individualisht dhe i tregojnë arritjet.

Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi. Njohja e nxënësit me vetëvlerësimin e ndërgjegjëson atë të kuptojë më mirë problemet e të mësuarit dhe i jep mundësi të caktojë objektiva për të ardhmen.

Përveç testeve me shkrim, mësuesit mund të përdorin dhe forma të tjera për të testuar pjesëmarrjen dhe ecurinë e nxënësve në mësimin e gjuhës së huaj të dytë në shkollë, si:

- Detyrat e shtëpisë;
- Projektet kurrikulare dhe ndërlëndore;
- Vrojtimet e mësuesit;

- Lista e kontrollit;
- Reflektimet, esetë;
- Modelet dhe maketet;
- Posterat;
- Lojërat dhe kuicet;
- Debatet;
- Loja me role;
- Portofoli.

Portofoli është një dokument kryesor për nxënësin, mësuesin dhe prindërit. Ai është një grumbullim sistematik i punëve të nxënësve dhe mundëson një vështrim krahasues të arritjeve të tyre për të stimuluar përparimin e tyre. Punët e grumbulluara bëjnë një regjistrim në vazhdimësi të zhvillimit dhe përparimit të nxënësve në përfundimin e njohurive, aftësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ai, gjithashtu, u jep nxënësve mundësinë të vetëvlerësohen dhe të reflektojnë në bazë të portofolit të tyre. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit bëhet me notë, e cila paraqet një mesatare të ponderuar të notave të vlerësimeve të kryera. Në këtë mesatare përfshihen notat e vlerësimeve me shkrim, me gojë, me projekte kurrikulare, etj.